



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

---

**Procesverbali për mbajtjen e dëgjimit publik me banor të fshatrave:  
Korishë, Lutogllavë, Malësi e Re, Lubizhdë, Skorobisht, Gërnqarë,  
Dojnicë dhe Novosellë**

**Me datë: 10.07.2024**, është publikuar njoftimi në webfaqe për mbajtjen e dëgjimit publik:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2024/07/Projekt-Buxheti-per-rajonin-e-Korishes-2025-2027.pdf>

**Me 10.07.2024**, është publikuar njoftimi si lajmë:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/njoftim-per-banoret-e-fshatrave-korische-malesi-e-re-lubizhde-skorobisht-dhe-gernqar-si-dhe-fshatrave-perreth-per-organizimin-e-degjimit-buxhetor-per-pergatitjen-e-buxhetit-te-vitit-2025/>

**Me 13.07.2024**, është publikuar projekt buxheti për vitin 2025/2027 për rajonin e Korishës:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2024/07/Projekt-Buxheti-per-rajonin-e-Korishes-2025-2027.pdf>

#### **Procesverbali:**

Dëgjimi me banor të fshatrave të rajonit të Korishës, gjegjësisht fshatrave: Lutogllavë, Malësi e Re, Lubizhdë, Skorobisht, Gërnqarë, Dojnicë, Novosellë i mbajtur me datë 18.07.2024

Dëgjimi ka filluar në orën: 19:40

**Ymer Berisha**, udhëheqës i Njesisë për Komunikim me Publikun ka hapur dëgjimin edhe në fshatin Korishë duke thënë se në këtë dëgjim publik jemi bashkë me Ju që të diskutojmë për buxhetin e vitit 2025, zyrtarët komunal përgjegjës janë duke mbajtur shënime dhe do të përgatisin procesverbalin dhe raportin dhe më pas këto dokumente do të publikohen në webfaqe dhe më pas ju mund ti shihni kërkesat tuaja.

**Kryetari Shaqir Totaj**, ka thënë se jemi këtu që të marrim kërkesat tuaja për vitin 2025. Për vitin 2025 buxheti për investime kapitale do te jetë 21 milion euro, e dimë që kërkesat dhe nevojat janë më të mëdha se sa mundësitë buxhetore, por që ju renditni kërkesat tuaja sipas prioriteteve. Takime të tilla ne do të kemi edhe në të ardhmen, dhe në këto takime ju përsëri do të keni mundësinë që të

diskutojmë për kërkesat tuaja, të gjitha kërkesat tuaja janë të arsyeshme por që ne do të shohim edhe mundësitë buxhetore duke u bazuar edhe në prioritete.

**Sulltan Badalli**, drejtor për Buxhet dhe Financa ka thënë se para juve ne sot po e paraqesim buxhetin e komunës së Prizrenit, apo politikën më të rëndësishme që e miraton kuvendi komunal i Prizrenit. Sipas qarkores buxhetore të ministrisë së financave, buxheti i komunës së Prizrenit do të jetë 70,982,477.00, i ndarë në këto kategori: Paga: 28,199,288.00; Mallra&Shërbime 14,240,244.00; Investime Kapitale 21,425,881.00; Shpenzime Komunale 1,055,299.00; Subvencione 4,561,785.0; Huamarrje 1,500,000.0 .

### **Kërkesat e qytetarëve:**

- Abaz Bobaj-Rregullimi i shtratit të lumit dhe kanalizimi.
  - Nderimi i shtëpis se Kulturës.
  - Perfundimi i rregullimit të varrezave të martirëve.
  - Rregullimi i kanalizimit në Lutogllav.
- Adem Ndrecaj – Kryerja e ndertimit të shkollës në Lutogllavë.
  - Zgjedhja e qështjes së ujit në Malësi të re.
  - Shtrimi me asphalt dhe ndertimi i varrezave.
  - Ndriqimi Publik.
- Sejdi Tafaj – Rregullimi dhe furnizimi me ujë të pijes në Lutogllavë.
- Sami Kabashi – Ndërtimi i bazenit për ujë të pijes te Laxheja të Xhamia
- Hasan Ahmetaj – Pastrimi i shtratit të lumit nga Shkolla Mehmet Akif.
- Ilir Xhaferi – Shtruarja e dysHEMEVE te klasave.
  - Lyerja e hapsirës së brendshme të shkollës.
  - Izolimi i jashtëm i shkollës.

- Rregullimi i kulmit të sallës sportive.
- Rexhep Bobaj-Uji i pijes të futet në sistemin e hidroregjionit.
  - Rregullimi i shtratit të lumit në fund të fshatit.
  - Rregullimi me fontan i 4 vareve të xhamia.

Dëgjimi ka përfunduar në orën 20:45.

Raportet për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore mund ti gjeni në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/prizren/category/degjimet-publike/raportet-degjimet-publike/> .

Projekt buxhetin për vitin 2025 dhe vitet 2026/2027, mund ti gjeni ne këtë vegez: <https://kk.rks-gov.net/prizren/category/degjimet-publike/projekt-buxheti/> .

Lajmi për mbajtjen e dëgjimit publik: <https://kk.rks-gov.net/prizren/news/komuna-e-prizrenit-organizon-11-degjime-per-buxhetin-e-vitit-2025/> .

Procesmbajtës:

Gjafer Ponik

Haziz Krasniqi